

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Raport sondazhi

Abonetë falas për pensionistë



Prill 2025

Përmbajtja

Raport sondazhi	1
Përmbajtja	2
Rreth sondazhit	3
Demografia	4
Rezultate	6

Rreth sondazhit

Në kuadër të angazhimit për të garantuar akses të barabartë dhe mbështetje sociale për grupet më të ndjeshme të shoqërisë, Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë një nismë të rëndësishme për ofrimin e abonesë falas në transportin publik për pensionistët. Kjo nismë synon të lehtësojë lëvizjen e përditshme të të moshuarve, duke ofruar ulje të kostove, për të mundësuar që kjo kategori të jetë pjesë aktive e jetës sociale dhe komunitare në qytet.

Për të vlerësuar ecurinë e kësaj nisme dhe për të identifikuar mënyrat më të mira për ta përmirësuar atë, është zhvilluar një sondazh për përfituesit e këtij shërbimi – pensionistët. Pyetësi kishte për qëllim mbledhjen e informacionit mbi përvojën e përdoruesve me abonenë falas, burimet e informimit, lehtësinë e procesit, frekuencën e përdorimit, kënaqësinë ndaj cilësisë së shërbimit si dhe sugjerimet për përmirësim.

Ky sondazh është zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Medias dhe Komunikimit me Qytetarët, nëpërmjet Sektorit të Konsultimit Publik dhe Opinionet Qytetare, dhe përfaqëson një hap konkret drejt forcimit të pjesëmarrjes qytetare dhe përfshirjes së drejtpërdrejtë të opinionit të pensionistëve në përmirësimin e politikave publike.

Të dhënat e mbledhura përmes këtij pyetësi jo vetëm që ndihmojnë në kuptimin më të mirë të përvojës reale të përfituesve të abonesë falas, por gjithashtu ofrojnë një bazë të rëndësishme për planifikimin e ndërhyrjeve të ardhshme për rritjen e cilësisë së transportit publik. Për më tepër, ato shërbejnë si një mjet për të monitoruar dhe përmirësuar efektivitetin e shërbimeve sociale të ofruara nga Bashkia e Tiranës.

Ky raport paraqet një përmbledhje të analizës së të dhënave të pyetësit, nxjerrjen e aspekteve kryesore dhe rekomandimet për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit të abonesë falas për pensionistët.

Qëllimi i sondazhit është të evidentojë opinionet e kategorisë së qytetarëve pensionistë, për aspektet kryesore të abonesë falas të tilla si informimi, vështirësitë për pajisje, sugjerime për përmirësimin e shërbimit etj.

Objektivat e sondazhit:

- a) Të evidentojë mënyrat e marrjes së informacionit dhe lehtësia në procesin e regjistrimit;
- b) Të përcaktojë frekuencën e përdorit të abonesë dhe vlerësimin për cilësinë e shërbimit të transportit publik;
- c) Të listojë linjat që përdorin më së shumti dhe përmirësime të mundshme për abonenë apo shërbimin;
- d) Të masë nëse e rekomandojnë abonenë falas edhe tek pensionistë të tjerë;
- e) Të mbledhë komente dhe sugjerime të hapura.


Sondazhi u zhvillua gjatë periudhës 02 – 28 prill 2025 dhe u anketuan pensionistë që kanë përfituar abone falas. Anketimi¹ u krye nëpërmjet intervistave ballë për ballë pranë pikave të shpërndarjes së aboneve dhe stacioneve të linjave urbane në qytet ku u plotësuan 510 pyetësorë², si edhe online në faqen zyrtare të internetit <https://tirana.al/faqe/sondazhe>, duke e shpërndarë në rrjetet sociale instagram dhe facebook të Sektorit të Konsultimit Publik dhe Opinioneve Qytetare.

¹ Pikat e anketimit


² Pyetësi i sondazhit

Demografia


Në këtë grafik paraqitet *shpërndarja e të anketuarve sipas njësive administrative ku banojnë*, ku Njësia Administrative Nr. 2 ka përqindjen më të lartë (14%), e ndjekur nga Njësia Administrative Nr. 3 me 12%, Njësia Administrative Nr. 4 me 10%, njësitet administrative nr: 5 dhe 8 me 8% secila etj. (Grafiku nr.1).



Të anketuarit për këtë sondazh janë 55% meshkuj dhe 45% femra (Grafiku nr.2).




17% e të anketuarve janë të moshës 72 vjeç, 10% janë të moshës 71 vjeç, 9% të moshës 63 vjeç, 7% të moshës 70 vjeç etj. (Grafiku nr.3).




Rezultate


43% e të anketuarve e kanë marrë informacionin për abonetë falas nga miqtë apo familjarët, 42% nga njësia administrative, 40% nga mediat sociale, 24% nga institucionet shtetërore (Grafiku nr.3).




38% e të anketuarve kanë vlerësuar mesatarisht *lehtësitë për regjistrimin dhe pajisjen me abone*, 35% janë shprehur se ka qenë e lehtë, 17% shumë e lehtë, 8% e vështirë dhe 1% shumë e vështirë (Grafiku nr.5).




Të pyetur se sa shpesh e përdorin abonenë falas për transportin publik, 34% e përdorin disa herë në muaj 27% disa herë në javë, 26% çdo ditë, 13% rrallë dhe 1% asnjëherë (Grafiku nr.6).




36% e pensionistëve pjesëmarrës në sondazh e kanë *vlerësuar mesatarisht shërbimin e transportit publik*, 26% janë të kënaqur, 20% të pakënaqur, 14% shumë të kënaqur dhe 4% shumë të pakënaqur (Grafiku nr.7).




Linjat urbane më të përdorura kanë rezultuar: Unaza 36%, Kombinat – Kinostudio 21%, Tirana e Re 17%, Porcelani 16% etj. (Grafiku nr.8).



Të pyetur se *çfarë përmirësimesh do të dëshironin për abononë falas apo transportin publik*, 55% janë shprehur për shtimin e frekuencës së linjave urbane, 46% për kushte më të mira si pastërtia dhe më shumë hapësirë, 36% përkatësisht për regjistrim online dhe pajisje digjitale si edhe shtimin e pikave të shpërndarjes së abonesë, 28% përkatësisht për pajisje automatike për tërheqjen e abonesë dhe më shumë informacion për procedurën e pajisjes me abone, ndërsa 4% për korsi të dedikuara për urbanët (*Grafiku nr.9*).



70% e atë anketuarve do ta rekomandonin abonesë falas edhe tek pensionistë të tjerë, 26% janë përgjigjur ndoshta, ndërsa 4% nuk janë të sigurt (Grafiku nr.10).



Aneks I – **Pikat e anketimit**

Nr.	(Stacione të linjave urbane dhe pikat e shpërndarjes së aboneve)
1	Biblioteka Kombetare; Rr.Kavajes; 15 kateshi <i>(pika të shpërndarjes)</i>
2	ish-Treni; Inxh Ndertimit; Brryli <i>(pika të shpërndarjes)</i>
3	Unaza
4	Unaza
5	Tirana e Re
6	Tirana e Re
7	Kombinat - Kinostudio
8	Kombinat - Kinostudio
9	Porcelani
10	Percelani
11	Tufina
12	Institut - Qender
13	Kashar
14	Teg – Sauk i Vjetër – Kopshti Zoologjik – Ish Stacioni i Trenit
15	Qendër – QTU – Megatek – City Park
16	Ish Kombinati i Autotraktorëve – Qender
17	Selitë – Kristal – Qendër – Stacioni i Trenit – Allias

Aneks II – Pyetësi i sondazhit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Nr. i pyetësit _____

Tiranë, më ____/____/2025

Pyetësor – ABONETË FALAS PËR PENSIONISTË

<i>Nj.Administrative/Lagje</i>	<i>Gjinia</i>		<i>Mosha</i>
	F	M	

1. Si e morët informacionin për abonenë falas për pensionistët?
(Mund të zgjidhni më shumë se një opsion)

- ☐ Nga mediat sociale
- ☐ Nga miqtë ose familjarët
- ☐ Nga institucionet shtetërore
- ☐ Nga njësia administrative
- ☐ Nga punonjësit e transportit publik
- ☐ Tjetër (Ju lutem specifikoni): _____

2. Si e vlerësoni lehtësinë e procesit të regjistrimit dhe pajisjes me abone?

- ☐ Shumë e lehtë
- ☐ E lehtë
- ☐ Mesatare
- ☐ E vështirë
- ☐ Shumë e vështirë

3. Sa shpesh e përdorni abonenë për transportin publik?

- ☐ Çdo ditë

- ☐ Disa herë në javë
- ☐ Disa herë në muaj
- ☐ Rrallë
- ☐ Asnjëherë

4. Sa të kënaqur jeni me cilësinë e shërbimit të transportit publik në Tiranë?

- ☐ Shumë të kënaqur
- ☐ Të kënaqur
- ☐ Neutral
- ☐ Të pakënaqur
- ☐ Shumë të pakënaqur

5. Cila është linja që përdorni më së shumti?

6. Çfarë përmirësimesh do të dëshironit për abonenë e pensionistit ose transportin publik? (Mund të zgjidhni më shumë se një opsion)

- ☐ Shtimi i pikave të shpërndarjes së abonesë
- ☐ Më shumë informacion mbi procedurën
- ☐ Pajisje automatike për tërheqjen e abonesë
- ☐ Regjistrim dhe pajisje online/digjitale
- ☐ Shtimi i frekuencës së linjave të autobusëve
- ☐ Përmirësimi i kushteve të autobusëve (pastërtia, hapësira etj.)
- ☐ Tjetër (Ju lutem specifikoni): _____

7. A do t'ua rekomandonit abonenë falas edhe pensionistëve të tjerë?

- ☐ Patjetër
- ☐ Ndoshta
- ☐ Nuk jam i sigurt

8. Komente dhe sugjerime për përmirësimin e shërbimit:

Shënim: Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim të evidentojë opinionet e pensionistëve për aspektet kryesore të abonesë falas të tilla si informimi, vështirësitë për pajisje, sugjerime për përmirësimin e shërbimit etj.

Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me Ligjin nr 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Ligjin nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”.

Ju falënderojmë për kohën që i kushtuat plotësimit të këtij pyetësori dhe për mendimet që ndatë me ne, me vlerë për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Tiranës.